



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.795/6prot.

Datë 16.05.2022

V E N D I M

Nr. 463/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.05.2022 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Rej” SHPK në procedurën e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetary*”, me Nr.REF-19625-02-14-2022, me objekt “Shërbim pastrimi, për Spitalin Universitar të Traumës”, me fond limit 137,991,275 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 17.03.2022, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

Ankimues: “REJ” SHPK
Zogu i Zi, Qatar Center Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Agjencia e Blerjeve të Përqendruara
Blv ”Dëshmorët e Kombit” Nd.1, 1001, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 15.02.2022 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit *E hapur, mbi kufirin e lartë monetary*, me Nr. REF-REF-19625-02-14-2022, me objekt Shërbim pastrimi, për Spitalin Universitar të Traumës”, me fond limit 137,991,275 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 17.03.2022, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve te Pergendruara.

II.2. Në datën 17.03.2022 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 06.04.2022 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

- BOE Meteo&Pastrime Silvio shpk	106,899,711.43	I skualifikuar
- Rej	113,365,021.65	I skualifikuar
- Clean fast	120,053,102.18	I skualifikuar
- Alko Impex General Construction	121,432,903.81	I skualifikuar
- Sori Al	136,612,710.76	I skualifikuar

II.5. Në datën 06.04.2022 operatori ekonomik “Rej” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

- *Ofertuesi nuk përmbush pikën 1, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, pasi nga dokumentacioni i paraqitur në SPE, rezulton se shërbimet e mëparëshme, të kryera gjatë 3 viteve të fundit, nuk janë të ngjashme me objektin e prokurimit. Furnizimet e mëparëshme, të paraqitura në SPE nga ofertuesi, kanë si objekt pastrimin e rrugëve, grumbullimin dhe transportin e mbetjeve për qytetet Pogradec, Perrenjas, Vlore si dhe shërbime të tjera mirëmbajtje të cilat nuk përbëjnë përvoja të mëparëshme të ngjashme me objektin e prokurimit (shërbim pastrimi i ambienteve të brendshme dhe të jashtme të godinës).*
- *Ofertuesi nuk përmbush pikën 2, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kriterëve të Vecanta për Kualifikim, pasi nga dokumentacioni i paraqitur në SPE, rezulton se operatori ekonomik ka paraqitur në tabelën e punonjesve, të dhëna mbi kontraktimin e 38 punonjësve sanitarë nga gjithsej 42 të kërkuar në pikën 2 seksioni 2.3 të Kërkesave të Vecanta për Kualifikim. Punonjesit sanitarë të deklaruar në listen e stafit nga ofertuesi në nr. rendorë 42 deri 51, rezultojnë të mos jenë të kontraktuar sic kerkohet në pikën 2 seksioni 2.3 të Kërkesave të Vecanta për Kualifikim.*
- *Ofertuesi nuk përmbush pikën 3/2, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kriterëve të Vecanta për Kualifikim, pasi nga dokumentacioni i paraqitur në SPE, rezulton se nuk disponon në pronësi ose me qera “dy makina larëse për ambientet e brendshme”. Për këtë kërkesë Ofertuesi ka paraqitur një kontratë blerje me kusht me subjektin Globi sh.p.k nga ku rezulton se kjo e fundit ka ende pronësinë e makinave larëse, në kundërshtim me kërkesën e AK ku kërkohet shprehimisht që subjekti ofertues të disponojë në pronësi ose qera mjetet e kërkuara në momentin e hapjes së ofertave.*
- *Ofertuesi nuk përmbush pikën 3/3, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kriterëve të Vecanta për Kualifikim, pasi nga dokumentacioni i paraqitur në SPE, rezulton se nuk disponon Makinë për larjen e rrugëve (Autobot) sipas kërkesave të AK. Nga leja e qarkullimit e paraqitur në SPE për autobotin AB048CF, rezulton se ky i fundit është dhënë me qira, pra nuk disponohet nga ofertuesi. Ndërsa, autoboti me targë AA294FF, referuar fotos së paraqitur, nuk rezulton të jetë sic kërkohet në DST, i pajisur me pompe për larjen e rrugëve me presion dhe i pajisur me tub për nxjerrjen e ujit në pjeset anesore të tij.*

II.6. Në datën 08.04.2022 autoriteti kontraktor, ka kryer Publikimin e Njoftim Anulimit në sistemin e prokurimeve elektronike.

II.7. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 15.04.2022 operatori ekonomik “Rej” SHPK, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik me pretendimet si më poshtë:

- *Lidhur me arsyen e parë të skualifikimit në profimin procedurës së prokurimit objekt ankimi në seksionin Tipi i kontratës është cituar shërbime dhe ne DT po ashtu cka tregon se jemi përpara një kontrate shërbimi. Referuar vlerës së fondit limit dhe kërkesave të AK vlera e shërbimit që OE duhet të plotësojë për tu kualifikuar është në shumën prej 55,196,510 lekë. Nga dokumentacioni i paraqitur shoqëria rej shpk lidhur me shërbimin e njëjtë të kryer me spitalin amerikan është në vlerën prej 217 600 euro pa tvsh (kontratë shërbimi spitali amerikan). Referuar preventivit pjesë e shërbimeve për tu realizuar janë edhe zërat sipërfaqe e jashtme për tu pastruar dhe sipërfaqe e jashtme për tu larë. Të gjitha kontratat e ngjashme të paraqitura nga OE ankimues zë zërat e tyre të preventivit përmbajnë zëra të njëjtë me ato si më sipër nënvizuar. Arsyet e skualifikimit nuk qëndron.*
- *Lidhur me arsyen e dytë të skualifikimit sqarojmë se kemi dorëzuar dokumentacion për znj Vilma Tërpollari i cili përbëhet nga kontrata e punës, id, diplomë librezë pune, certifikatë për VNM, librezë pune, dëshmi kualifikimi, CV. Për sa i përket stafit përgjegjës me profil Ing Kimist apo ing Mjedisi janë paraqitur dokumentacion për shtetasit Hasan Xaka dhe Florenc Gora. Lidhur me punonjësit sanitarë nga AK është parashikuar në DT se në zbatim të ndryshimeve ligjore OE duhet të paraqesin kontratat individuale të punës si dhe diplomat e cdo punonjësi pranë AK jo më vonë se 5 ditë nga publikimi i njoftim fituesit. Së pari pra dokumentacioni i sipërcituar referuar vetë deklaramentit të AK në DT paraqitet pas shpalljes së fituesit dhe jo në momentin e vlerësimit. Për rrjedhojë skualifikimi në këtë fazë për këtë kriter është i pavlefshëm. Nga ana e OE është paraqitur shtojca përmbledhëse e cila në seksionin për disponimin e punonjësve dhe makinerive në faqet 11-16 është paraqitur lista emërore e punonjësve sanitar të kërkuar. OE ka deklaruar se këta persona do të jenë të angazhuar në rast të shpalljes fitues të OE dhe pas këtij momenti OE ka detyrimin të paraqesë kontratat e punës si më sipër sqaruar. Ak ngrre hamendësime mbi profilin e tyre pa u njohur më parë me kontratën e lidhur mes palëve. Arsyetja e skualifikimit nuk qëndron.*
- *Lidhur me arsyen e tretë të skualifikimit sqarojmë se nga ana e OE është paraqitur shtojca mbi disponimin e mjeteve dhe vendosur dhe kontrata e shitjes me subjektin Globi shpk. Për të provuar pronësinë e tyre OE ka paraqitur kontratën e shitjes me kusht të lidhur me OE Globi shpk e cila është një kontratë e cila njohet nga Kodi Civil i RSH i mjet juridik i fitimit të pronësisë. Ligjvënësi ka parashikuar se kërkimi për sa i takon mjeteve dhe pajisjeve teknike nuk mund të lidhen me disponimin e tyre në castin e zhvillimit të procedurës por edhe ato të cilat mund të vohen në dispozicion nga OE për të përmbushur kontratën. Arsyetja e skualifikimit nuk qëndron.*
- *Lidhur me arsyen e katërt të skualifikimit sqarojmë se kemi paraqitur mjetin me targë AA294FF për të cilin është paraqitur kontrata e qerasë e lidhur me shoqërinë Adriatik shpk si një nga mënyrat e kërkuara nga AK në DT. Arsyetja e skualifikimit nuk qëndron.*

- Sa më sipër kërkojmë kualifikimin e ofertës tonë.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.795/2 prot datë 19.04.2022 me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Rej” SHPK.

II.8. Me shkresën nr. 669 prot, datë 27.04.2022 me objekt: “Informacion”, protokolluar me tonën me nr. 795/4 prot datë 29.04.2022 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni dhe vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Rej SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur mospranimi i ankesës.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyen se “Ofertuesi nuk përmbush pikën 1, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, pasi nga dokumentacioni i paraqitur në SPE, rezulton se shërbimet e mëparëshme, të kryera gjatë 3 viteve të fundit, nuk janë të ngjashme me objektin e prokurimit. Furnizimet e mëparëshme, të paraqitura në SPE nga ofertuesi, kanë si objekt pastrimin e rrugëve, grumbullimin dhe transportin e mbetjeve për qytetet Pogradec, Perrenjas, Vlore si dhe shërbime të tjera mirëmbajtje të cilat nuk përbëjnë përvoja të mëparëshme të ngjashme me objektin e prokurimit (shërbim pastrimi i ambjentëve të brendshme dhe të jashtme të godinës), Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 2 “lista e çmimeve” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Lista e Çmimeve

SHERBIM PASTRIMI TE AMBJENTEVE TE BRENDSHME DHE TE JASHTME PER SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS

Nr.	Sipërfaqe totale per tu pastruar	Njësia	Ditë kalendarike	Sasia 36 muaj	Cmimi per njesi	Vlera Totale
Siperfaqe te brendshme per tu pastruar						
1	Pastrim i brendshëm me shërbim 8-orësh(2,046.56*1) (Administratë)	m ²	247	1,516,500.96		
2	Pastrim i brendshëm me shërbim 8-orësh(3,156.033*1) (Shërbime për pacientet)	m ²	247	2,338,620.45		
3	Pastrim i brendshëm me shërbim 16-orësh (244.333 X 2 turne)(Recepsioni)	m ²	365	535,089.27		
4	Pastrim i brendshëm me shërbim 16-orësh (1,028.75 X 2 turne)(Blloku Operator)	m ²	247	1,524,607.50		

5	Pastrim i brendshëm me shërbim 24-orësh (2,253 X 3 turne) (Urgjenca +Reanimacioni)	m ²	365	7,401,105.00		
6	Pastrim i brendshëm me shërbim 24-orësh (7,949.823 X 3 turne)	m ²	365	26,115,168.56		
Siperfaqe te jashtme per tu pastruar						
1	Siperfaqet e jashtme per tu pastruar	m ²	365	17,882,773.50		
2	Siperfaqet e jashtme per tu lare	m ²	230	11,268,597.00		
Fondi i Marreveshjes Kuader Leke (pa TVSH)						137,991,275

III.1.2. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 2.3.1 “kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

1. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:*
 - a) *Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe*

të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- b) *Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik ankimes Rej shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë Shërbimi Nr. 767/6 prot datë 25.02.2020 me objekt Vazhdim i shërbimit të pastrimit grumbullimi dhe largimi i mbeturinave të qytetit Pogradec dhe njësisë administrative për nevojat e fillim vitit për shkaqe të paparashikuara me vlerë 53,068,996 lekë pa tvsh. Vërtetim realizimi, Fatura tatimore shitje, Situacione.
- Kontratë Shërbimi nr.2295/3 datë 30.07.2020 me objekt Pastrimi grumbullimi dhe largimi i mbeturinave të qytetit Pogradec dhe njësisë administrative, me vlerë një vjecare 100,856,932 dhe vlerë 5 vjecare 605,141,592 lekë me tvsh. Fatura tatimore, situacione.
- Kontratë Shërbimi Nr.4588 prot datë 30.12.2019 me objekt Pastrim, grumbullim dhe transportin e mbeturinave në teritorin administrativ të bashkisë Prrrenjas , 5 vjecar, me vlerë totale të kontratës për 5 vjet 59,232,063.12 lekë me tvsh. Vërtetime Realizimi.Fatura dhe Situacione.
- Kontratë Shërbimi Nr.6483 prot datë 30.07.2020 me objekt Shërbimi i pastrimit të njësisë administrative Qendër Novoselë Shushicë të Bashkisë Vlorë, me vlerë 78,594,536 lekë me tvsh. Fatura Tatimore, Situacione, Vërtetim realizimi.
- Kontratë Shërbimi datë 01.04.2021 me objekt Mirëmbajtje e objekteve spitalore ku ushtron aktivitetin klienti , dhënia e shërbimeve sanitare dhe ose të pastrimit të ambjentëve të brendshme si dhe të jashtme të porositësit nga ana e ofruesit të shërbimeve, dhënia e shërbimit të dezinfektimit në ambjentet e brendshme për rastet e infektuara me covid, me afat një vjecar me vlerë 20,000 euro pa tvsh në muaj.Fatura tatimore, situacione.

III.1.4. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) *aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

III.1.5. Neni 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

- *Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*
- *Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*
- *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

III.1.6. Komisioni gjykon se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.7. Referuar sa me sipër, nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Rej” SHPK në përmbushje të kriterit për përvojë të ngjashme, KPP vëren se ky i fundit ka paraqitur disa kontrata shërbimi me objekt shërbimit të pastrimit

grumbullimi dhe largimi i mbeturinave si dhe mirëmbajtje e objekteve spitalore, dhënia e shërbimeve sanitare dhe ose të pastrimit të ambjentëve të brendshme si dhe të jashtme të porositësit nga ana e ofruesit të shërbimeve, dhënia e shërbimit të dezinfektimit në ambjentet e brendshme. KPP vëren se në pjesën më të madhe të kontratave të sipërcituara sic janë ato të lidhura me bashkinë Pogradec, bashkinë Prenjas dhe bashkinë Vlorë janë kryer shërbime të ndryshme si mirëmbajtje rrugësh, pastrim kanalesh, lumenjsh por në to konstatohet se janë kryer në një pjesë të konsiderueshme zërat si shërbime larje dhe pastrim rrugësh me fshesë dhe makineri. Komisioni gjykon të konsiderojë të ngjashëm zërat e shërbimeve larje dhe fshirje të kryera nga ankimuesi në kontratat e paraqitura. Konkretisht për këto zëra vlera e shërbimi në total për të gjitha kontratat e realizuara me entet publike arrin në 42,547,342 lekë pa tvsh. KPP vëren gjithashtu se ankimuesi ka realizuar një kontratë të njëjtë me objektin e prokurimit të lidhur me Spitalin Amerikan vlera e së cilës është në shumën 20.000 euro në muaj ose 240,000 euro në vit (295,200 milion leke) e cila dëshmonë për eksperiencën e ngjashme të ankimuesit për pastrimin e ambjeteve të brendshme. Referuar kriterit të vecantë të kualifikimit rezulton se autoriteti kontraktor ka kërkuar dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit. KPP referuar vlereës së fondit limit 137,991,275 gjykon se vlera e kontratave të ngjashme që duhet të plotësohet nga ankimuesi është në shumës 55,196,510 lekë pa tvsh.. KPP pasi vecoi zërat e shërbimeve që mund të konsiderohen të ngjashme me objektin e prokurimit si me siper cituar vëren se vlera e tyre arrin të përmbushë vlerën e kërkuar nga autoriteti kontraktor në kriterin e vecantë të kualifikimit në masën prej 40% të fondit. Në këtë kuptim, KPP gjykon se operatori ekonomik Rej SHPK me dokumentacionin e paraqitur provon se ka kryer shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit duke plotësuar kështu kërkesën për kualifikim, për përvojë të suksesshme, pasi kontratat e paraqitura përmbajnë zera te cilat jane te ngjashem me objektin e prokurimit dhe ato zera qe KPP i konsideroi te ngjashem jo vetëm mjaftojnë por tejkalojnë vleren e kerkuar në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi. Në këtë kuptim, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Rej” ShPK është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyen se *Ofertuesi nuk përmbush pikën 2, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kriteve të Vecanta për Kualifikim, pasi nga dokumentacioni i paraqitur në SPE, rezulton se operatori ekonomik ka paraqitur në tabelën e punonjesve, të dhëna mbi kontraktimin e 38 punonjësve sanitarë nga gjithsej 42 të kërkuar në pikën 2 seksioni 2.3 te Kërkesave të Vecanta për Kualifikim. Punonjesit sanitarë te deklaruar ne listen e stafit nga ofertuesi ne nr. rendorë 42 deri 51, rezultojnë të mos jenë të kontraktuar sic kerkohet në pikën 2 seksioni 2.3 te Kërkesave të Vecanta për Kualifikim.*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 2.3.2 “kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2. *Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të ketë minimalisht 45 (dyzetë e pesë) persona të punësuar, në profilet sipas tabelës si mëposhtme:*

Stafi	Nr.
<i>Drejtues Teknik- me profil Inxhinier kimist ose Inxhinier mjedisi</i>	<i>1 (një)</i>
<i>Pergjegjes me profil Inxhinier kimist ose Inxhinier mjedisi</i>	<i>2 (dy)</i>
<i>Sanitare</i>	<i>42 (dyzetë e dy)</i>
Totali i punonjësve	<i>45 (dyzetë e pesë)</i>

- *Për Drejtuesin Teknik, me profil - Inxhinier kimist ose Inxhinier mjedisi OE duhet te paraqes:*
 - *Kontrate individuale per drejtuesin teknik;*
 - *Diplomen perkatese;*
 - *Ne zbatim te akteve ligjore, drejtuesi i mesiperm nuk duhet te figuroje i dy punesuar ne sektor privat apo publik. Per kete administratori i operatorit ekonomik te paraqes deklarate perkatese.*
 - *Drejtuesi nuk duhet te jete i angazhuar ne kontrata te tjera gjate periudhes se realizimit te objektit. Per kete arsye te paraqitet deklarate perkatese nga Administratori/Drejtuesi Ligjor i shoqerise.*
- *Per punonjësit Pergjegjes me profil Inxhinier kimist ose Inxhinier mjedisi, te paraqitet vetem kontrate pune perkatese.*
- *Per punonjësit Sanitare, te paraqitet vetem kontrate pune perkatese.*

Operatori ekonomik te paraqes deklarate ne lidhje me stafin qe disponon sipas formatit te meposhtem:

<i>Nr</i>	<i>Emer Mbiemer</i>	<i>Profesioni</i>	<i>Data e fillimit te marredhenieve te punes</i>

Ne zbatim te ndryshimeve te reja ligjore Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin kontratat individuale te punes si dhe diplomat e cdo punonjesi prane AK jo me vone se 5 dite nga publikimi i njoftimit te fituesit perfundimtar.

***Shenim 4.1:**

Me qellim garantimin e gjithe perfshirjes, per ti dhene mundesi cdo operatori ekonomik per te marre pjese ne proceduren perkatese te prokurimit, punonjesit e mesiperm jo domosdoshmerisht duhet te figurojne ne listepagesat e shoqerise. Punonjesit mund te kontraktohen nga operatori ekonomik enkas per kete procedure prokurimi.

Stafi qe do te deklarohet detyrimisht do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor per te qene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

Stafi i cili do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor, per zbatimin e kesaj kontrate, nuk duhet te jete i angazhuar ne kontrata te tjera, deri ne perfundim te kontrates. Per kete arsye te paraqitet deklarate perkatese nga Administratori/Drejtuasi Ligjor i shoqerise. Rastet e deklaratave te rreme, do te konsiderohen kushte per skualifikim, si dhe do te ndiqet procedura per perjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik ankimues Rej shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Deklaratë stafi në të cilën deklarohen ndër të tjera në cilësinë e punonjësve sanitare nga numri rendor 4-51 në total 47 sanitare.
- Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit

III.2.3. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) *aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës

III.2.4. Neni 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

- *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*
- a) *licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose 41*
- c) *fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) *mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

III.2.5. Komisioni gjykon se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe

besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.2.6. Referuar sa më sipër KPP vëren se autoriteti kontraktor ka kërkuar disponimin nga ana e operatorëve ekonomikë të një stafi prej 45 personash nga të cilët 1 drejtues teknik me profil inxhinier kimist ose mjedisi, një përgjegjës me profil inxhinier kimist ose inxhinier mjedisi si dhe 42 sanitarë. Autoriteti kontraktor ka kërkuar gjithashtu dokumentacion për provueshmërinë e stafit sic është kontrata pune dhe diploma si dhe dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të një deklaratë në lidhje me stafin sipas një formati të caktuar pasqyruar më sipër. Ndërkohë autoriteti kontraktor ka nënvizuar se në zbatim të ndryshimeve të reja ligjore Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin kontratat individuale të punës si dhe diplomat e cdo punonjësi prane AK jo më vonë se 5 dite nga publikimi i njoftimit të fituesit perfundimtar. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ankimuesi për përmbushjen e kriterit lidhur me 42 punonjës sanitarë KPP vëren se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike deklartën e stafit në përputhje me formatin e kërkuar në të cilin ka deklaruar nga numri rendor 4 deri 51 punonjësit me profil sanitarë pra në total 47 sanitarë. Për punonjësit e deklaruar në numrin rendor 42 deri në 51 ankimuesi ka deklaruar se: Ne rast se subjekti REJ shpk do të shpallet fitues në procedurën e prokurimit me objekt "Shërbim pastrimi, për Spitalin Universitar të Traumës" me Autoritet Kontraktor Agjencia e Blerjeve të Perqendruara do të lidhet kontratë me kohe të plotë. KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues ka paraqitur dokumentacionin lidhur me punonjësit sanitarë të kërkuar në përputhje me kërkesat në kriterin e vecantë të kualifikimit. Kështu autoriteti kontraktor ka theksuar se për përmbushjen e kriterit në fazën e vlerësimit ofertuesit do të duhet të paraqesin deklartatën e stafit ndërsa në zbatim të ndryshimeve të reja ligjore Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin kontratat individuale të punës si dhe diplomat e cdo punonjësi prane AK jo më vonë se 5 dite nga publikimi i njoftimit të fituesit perfundimtar. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit dhe informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor nuk rezultojnë që autoriteti kontraktor të ketë kërkuar dokumentacionin e punonjësve nga ana e operatorit ekonomik ankimues. Në këtë kuptim KPP gjykon se autoriteti kontraktor ka skualifikuar operatorin ekonomik Rej shpk me argumenta të pabazuara dhe në tejkalim të kriterit të vecantë të kualifikimit. Vëtë autoriteti kontraktor ka lejuar ofertuesit të kontraktajnë rishtazi stafin e nevojshëm për realizimin e kontratës duke përcaktuar se *Me qellim garantimin e gjithë perfshirjes, për të dhene mundesi cdo operatori ekonomik për të marre pjese në procedurën perkatëse të prokurimit, punonjësit e mesiperm jo domosdoshmerisht duhet të figurojne në listepagesat e shoqerise. Punonjësit mund të kontraktohen nga operatori ekonomik enkas për këte procedure prokurimi.* Në këtë kuptim

KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues ka paraqitur dokumentacionin lidhur me punonjësit sanitarë në përputhje me kriterin e kualifikimit.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyen se “Ofertuesi nuk përmbush piken 3/2, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kriteve të Vecanta për Kualifikim, pasi nga dokumentacioni i paraqitur në SPE, rezulton se nuk disponon në pronësi ose me qera “dy makina larëse për ambjentet e brendshme”. Për këtë kërkesë Ofertuesi ka paraqitur një kontratë blerje me kusht me subjektin Globi sh.p.k nga ku rezulton se kjo e fundit ka ende pronësinë e makinave larëse, në kundërshtim me kërkesën e AK ku kërkohet shprehimisht që subjekti ofertues të disponojë në pronësi ose qera mjetet e kërkuara në momentin e hapjes së ofertave”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 2.3.3 “kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

3. Operatori ekonomik duhet të deklarojë se disponon, makinerite, dhe pajisjet, si më poshtë:

<i>Nr</i>	<i>Emri i mjetit</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasitë minimale</i>	<i>Statusi</i>
1	<i>Dy makineri larese per ambjentet e brendshme</i>	<i>copë</i>	<i>2 (dy)</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
2	<i>Vinç me kosh per larjen e dritareve ne lartesi</i>	<i>copë</i>	<i>1 (nje)</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
3	<i>Makine per larjen e rrugeve (Autobot) te pajisur me pompe per larjen e rrugeve me presion, pajisur me tub per nxjerrjen e ujit ne pjeset anesore te tij, me kapacitet mbajtes minimumi 7000 deri ne 8000 litra ujë <u>shoqeruar me foto te dukshme te mjetit</u></i>	<i>copë</i>	<i>1 (nje)</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>

Shënim 5.1:

Në zbatim të ndryshimeve të reja ligjore operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë AK jo më vonë se 5 dite nga publikimi i njoftimit të fituesit përfundimtar, dokumentacion për pajisjet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Autoriteti Kontraktor, pas dorezimit të dokumentacionit të mesiperm pas publikimit të Njoftimit Fitues perfundimtar, do të verifikoj prane ambienteve të operatorit disponueshmerine e pajisjeve e deklaruar.

Mjetet që do të deklarohen, detyrimisht do të paraqiten Autoritetit Kontraktor për të gene pjese e planit të zbatimit të kontrates.

Rastet e deklaratave të rreme, do të konsiderohen kushte për skualifikim, si dhe do të ndiqet procedura për perjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.

III.3.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik Rej shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër lidhur me disponimin e 2 makinerive larëse për ambientet e brendshme ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë për shitje mjeteve me kusht datë 15.03.2022 lidhur ndërmjet shoqëria Globi shpk dhe Rej shpk me objekt Mjet larës për ambiente të brendshme copë 2. Palët bien dakord që shitja do të kushtëzohet nga realizimi i kushtit të poshtëshënuar: Blerësi shpallet fitues i procedurës së prokurimit Shërbim pastrimi, për Spitalin Universitar të Traumës”, zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Perqendruara. Cmimi i kontratës është 964,000 lekë.

III.3.3. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës

III.3.4. Neni 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

- *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*
- a) *licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose 41*
- c) *fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) *mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

III.3.5. Komisioni gjykon se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.3.6. Referuar sa më sipër KPP vëren se autoriteti kontraktor ka kërkuar deklarin e disponimit nga ana e operatorëve ekonomikë të dy makinerive larëse për ambjentet e brendshme. Gjithashtu autoriteti kontraktor ka nënvizuar se në zbatim të ndryshimeve të reja ligjore operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë AK jo më vonë se 5 dite nga publikimi i njoftimit të fituesit perfundimtar, dokumentacion për pajisjet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / **çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë**).

III.3.7. Neni 84 “Veprimet juridike me kusht: i Kodit Civil parashikon shprehimisht se: *Veprimi juridik është me kusht kur lindja ose shuarja e të drejtave dhe e detyrimeve të parashikuara në të, varen nga një ngjarje e cila nuk dihet në se do të ndodhë.* Në rastin konkret kontrata e paraqitur nga operatori ekonomik ankimes ka cilësinë e një veprimi juridik me kusht në kuptim të nenit 84 të sipërcituar. KPP vëren se autoriteti kontraktor ka lejuar në kriterin e vecantë të kualifikimit se dokumentacioni i disponimit të mjeteve do të paraqitet në përputhje me ndryshimet e fundit ligjore jo më vonë se 5 dite nga publikimi i njoftimit të fituesit perfundimtar. Autoriteti kontraktor ka theksuar se për kriterin sa më sipër pranohet cdo dokument që, që vërtetojnë se, këto pajisje i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë). KPP gjykon se operatori ekonomik ankimes për të provuar disponimin e mjeteve të kërkuara në kriterin e vecantë të kualifikimit ka paraqitur kontratën me kusht e cila është një veprim juridik i njohur nga legjislacioni jonë si një mjet për fitimin e pronësisë i cili kushtëzohet me plotësimin e kushtit. KPP gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga ankimesi është i vlefshëm dhe përmbush kriterin e vecantë të kualifikimit të përcaktuar në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi. Për më tepër autoriteti kontraktor ka përcaktuar se pas dorezimit të dokumentacionit të mesiperm pas publikimit të Njoftimit Fitues perfundimtar, do të verifikoj

prane ambienteve te operatorit disponueshmerine e pajisjeve e deklaruar. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinale ose në kopje të njësuara me origjinalin, për t'u siguruar nëse cilësia e shërbimit, punës apo mallit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në momentin apo fazën e ofertimit.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyen se *“Ofertuesi nuk përmbush piken 3/3, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kriteve të Vecanta për Kualifikim, pasi nga dokumentacioni i paraqitur në SPE, rezulton se nuk disponon Makinë për larjen e rrugëve (Autobot) sipas kërkesave të AK. Nga leja e qarkullimit e paraqitur në SPE për autobotin AB048CF, rezulton se ky i fundit është dhënë me qira, pra nuk disponohet nga ofertuesi. Ndërsa, autoboti me targë AA294FF, referuar fotos se paraqitur, nuk rezulton të jetë sic kërkohet në DST, i pajisur me pompe per larjen e rrugeve me presion dhe i pajisur me tub per nxjerrjen e ujit ne pjeset anesore te tij”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se*

III.4.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 2.3.3 “kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

1. *Operatori ekonomik duhet të deklarojë se disponon, makinerite, dhe pajisjet, si më poshtë:*

<i>Nr</i>	<i>Emri i mjetit</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasitë minimale</i>	<i>Statusi</i>
1	<i>Dy makineri larese per ambjentet e brendshme</i>	<i>copë</i>	<i>2 (dy)</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
2	<i>Vinç me kosh per larjen e dritareve ne lartesi</i>	<i>copë</i>	<i>1 (nje)</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
3	<i>Makine per larjen e rrugeve (Autobot) te pajisur me pompe per larjen e rrugeve me presion, pajisur me tub per nxjerrjen e ujit ne pjeset anesore te tij, me kapacitet mbajtes minimumi 7000 deri ne 8000 litra ujë <u>shoqeruar me foto te dukshme te mjetit</u></i>	<i>copë</i>	<i>1 (nje)</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>

Shënim 5.1:

Në zbatim të ndryshimeve të reja ligjore operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë AK jo më vonë se 5 dite nga publikimi i njoftimit të fituesit perfundimtar, dokumentacion për pajisjet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimit / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Autoriteti Kontraktor, pas dorëzimit të dokumentacionit të mesipërme pas publikimit të Njoftimit Fitues perfundimtar, do të verifikoj pranë ambienteve të operatorit disponueshmerine e pajisjeve e deklaruarat.

Mjetet që do të deklarohen, detyrimisht do të paraqiten Autoritetit Kontraktor për të gjetur pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

Rastet e deklaratave të rreme, do të konsiderohen kushte për skualifikim, si dhe do të ndiqet procedura për përjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.

III.4.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik Rej shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër lidhur me një makine për larjen e rrugëve (Autobot) të pajisur me pompe për larjen e rrugëve me presion, pajisur me tub për nxjerrjen e ujit në pjesët anësore të tij, me kapacitet mbajtës minimumi 7000 deri në 8000 litra ujë shoqëruar me foto të dukshme të mjetit, në pronësi ose me qera, ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë qiraje lidhur midis shoqëria Adriatik shpk në cilësinë e qeradhënësit dhe shoqëria Rej shpk në cilësinë e qeramarrësit me objekt Autobot uji me peshë mbajtëse 7-8 ton i pajisur me pomë për larjen e rrugëve me presion me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme me targë AA294FF. Leje qarkullimi, Certifikatë pronësie, Certifikatë e kontrollit teknik, Policë sigurimi, Foto, Certifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit.
- Leje qarkullimi për mjetin me targa AB048CF, Certifikatë Pronësie, Certifikatë e kontrollit teknik, Police sigurimi, Certifikatë për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet, Foto.

III.4.3. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) *përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) *aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës

III.4.4. Neni 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

- *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*
- *a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- *b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose 41*
- *c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- *ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

III.4.5. Komisioni gjykon se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.4.6. Referuar sa më sipër KPP vëren se autoriteti kontraktor ka kërkuar deklarin e disponimit nga ana e operatorëve ekonomikë të 1 makine per larjen e rrugeve (Autobot) te pajisur me pompe per larjen e rrugeve me presion, pajisur me tub per nxjerrjen e ujit ne pjeset anesore te tij, me kapacitet mbajtes minimumi 7000 deri ne 8000 litra ujë shoqeruar me foto te dukshme te mjetit Gjithashtu autoriteti kontraktor ka nënvizuar se në zbatim të ndryshimeve te reja ligjore operatorët ekonomikë duhet të paraqesin prane AK jo me vonë se 5 dite nga publikimi i njoftimit te fituesit perfundimtar, dokumentacion për pajisjet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë). Nga shqyrimi në tërësi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik rezulton se për përmbushjen e kriterit lidhur me disponimin e një mjeti autobot është dorëzuar Kontratë qeraje lidhur midis shoqëria Adriatik shpk në cilësinë e qeradhënësit dhe shoqëria Rej shpk në cilësinë e qeramarrësit me objekt

Autobot uji me peshë mbajtëse 7-8 ton i pajisur me pomë për larjen e rrugëve me presion me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme me targë AA294FF. Leje qarkullimi, Certifikatë pronësie, Certifikatë e kontrollit teknik, Policë sigurimi, Foto, Certifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit. KPP gjykon se arsyeja e skualifikimit dhënë ankimuesit nga autoriteti kontraktor nuk është e qartë dhe nuk është dhënë asnjë argument pse mjete të cilat janë dhënë me qera nuk disponohet nga ankimuesi sipas autoritetit kontraktor. KPP gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga ankimuesi është në rastin konkret është i vlefshëm dhe përmbush kriterin e vecantë të kualifikimit të përcaktuar në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi. Për më tepër autoriteti kontraktor ka përcaktuar se pas dorëzimit të dokumentacionit të mesipër pas publikimit të Njoftimit Fitues perfundimtar, do të verifikoj pranë ambienteve të operatorit disponueshmerine e pajisjeve e deklaruar. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinale ose në kopje të njësuara me origjinalin, për t'u siguruar nëse cilësia e shërbimit, punës apo mallit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në momentin apo fazën e ofertimit.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, 115 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 *“Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Rej” SHPK për procedurën e prokurimit *“E hapur, mbi kufirin e lartë monetary”*, me Nr.REF-19625-02-14-2022, me objekt *“Shërbim pastrimi, për Spitalin Universitar të Traumës”*, me fond limit 137,991,275 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 17.03.2022, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Perqendruara.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Rej” SHPK, si dhe të korrigojë shkeljet, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vëre në dijëni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Rej” SHPK.

5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri